



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

MENAXHIMI I CILËSISË NË PRODHIMIN BUJQËSOR¹

Niveli V në KSHK², referuar niveli V të KEK³

H1-V-23

Tiranë, 2023

¹ Bëhet fjalë vetëm për prodhimin bimor

²Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

³Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“Menaxhimi i cilësisë në prodhimin bujqësor”		Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli V në KSHK, referuar niveli V të KEK	H1-V-23
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i arsimimit profesional në drejtimin “ Menaxhimi i cilësisë në prodhimin bujqësor ” niveli V në KSHK, referuar niveli V të KEK, është të pajisë individin me njohuri dhe aftësi profesionale për menaxhimin e cilësisë në prodhimin bujqësor <i>për t’u punësuar apo vetëpunësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me fushën e bujqësisë.</i>		
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në drejtimin “Menaxhimi i cilësisë në prodhimin bujqësor” niveli V në KSHK, referuar niveli V të KEK, kanë të drejtë të hyjnë të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional në kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK. - kanë përfunduar arsimimin në niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK dhe kanë njohuri dhe përvojë pune, të paktën 1 vit, të vërtetuar në fushën e bujqësisë. - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. <p>Pranohen dhe individë që kërkojnë të përmirësojnë dhe përditësojnë vazhdimisht njohuritë dhe aftësitë e tyre, kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, institucioni përgjegjëse përgatit udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimit për këto shkolla</p>		
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Menaxhimi i cilësisë në prodhimin bujqësor” niveli V në KSHK, referuar niveli V të KEK, e pajis individin me certifikatën dhe suplementin përkatës të këtij niveli.</p> <p>Ky kualifikim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për të punuar si menaxher i mesëm i cilësisë në prodhimin bujqësor në njësi të furnizimit, prodhimit bujqësor, qendra të grumbullimit, tregtimit dhe agropërpunimit.</p> <p>Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e bujqësisë.</p>		
Data e validimit	<i>Qershor 2023</i>		
Data e miratimit			
Variantet e mëparshme			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë:

Bazat e bujqësisë

- Të tregojë zhvillimet kryesore në fushën e bujqësisë;
- Të vlerësojë kushtet agro klimatike;
- Të përshkruajë rëndësinë e rajonizimit të kulturave në cilësinë e prodhimit;
- Të dallojë traditat e kultivimit të bimëve bujqësore sipas zonave dhe kërkesave të tregut;
- Të përshkruajë strukturat varietore të kulturave bujqësore;
- Të klasifikojë tipet e tokës;
- Të argumentojë dinamikën e qarkullimit të ujit në tokë;
- Të shpjegojë rritjen dhe zhvillimin e bimëve bujqësore;
- Të argumentojë rolin dhe skemat e qarkullimit bujqësor;

Teknologjitë e prodhimit bujqësor

- Të shpjegojë sistemet e ndryshme të prodhimit bujqësor: konvencional, biologjik, të integruar, biodinamik, agropyjor;
- Të shpjegojë e karakteristikave të tokës;
- Të argumentojë trajtimet e duhura para mbjelljes për ruajtjen e cilësisë së prodhimit;
- Të shpjegojë llojet dhe mënyrat e punimit të tokës sipas sistemit të kultivimit;
- Të krahasojë sistemet e kultivimit dhe proceset respektive të punës;
- Të argumentojë skemat e ushqyerjes së bimëve sipas llojit;
- Të shpjegojë sistemet e ujitjes sipas teknologjisë së kultivimit;
- Të listojë dëmtuesit e zakonshëm dhe ato karantinor;
- Të listojë PMB⁴ sipas përdorimit;
- Të argumentojë zbatimin e metodave dhe të teknikave të mbrojtjes së bimëve për kontrollin e dëmtuesve;
- Të interpretojë shërbimet agroteknike sipas fazave fenologjike të bimës;
- Të shpjegojë afatin optimal dhe teknikat e vjeljes së produktit sipas kërkesave të tregut;
- Të shpjegojë rëndësinë e përditësimit me teknologjitë e reja në prodhimin bujqësor;
- Të vlerësojë rolin e përdorimit të teknologjive në menaxhimin e fermës për prodhimin e produkteve bujqësore

Teknologjitë e pas vjeljes dhe ruajtjes

- Të shpjegojë ndryshimet fizike, kimike dhe fiziologjike të produkteve bujqësore para dhe

⁴Produktet e mbrojtjes së bimëve

- pas vjeljes;
- Të krahasojë prognozën dhe kriteret e përcaktimit të shkallës së pjekjes për vjelje;
 - Të vlerësojë humbjet dhe faktorët e humbjeve të produktit gjatë proceseve të transportit, seleksionimit, paketimit, ruajtjes dhe tregtimit;
 - Të tregojë hallkat dhe trajtimet para dhe pas vjeljes të produktit si: vjelja, ftohja, pastrimi, seleksionimi, paketimi ruajtja, transporti, marketingu dhe përdorimi nga konsumatori;
 - Të listojë materialet, mjetet dhe teknikat e përdorura gjatë trajtimeve para dhe pas vjeljes;
 - Të shpjegojë paraftohjen dhe ruajtjen e ftohtë;
 - Të shpjegojë kushtet optimale të ruajtjes (temperaturën, lagështia etj.) dhe rëndësinë e kontrollit të tyre për sigurimin e cilësisë;
 - Të krahasojë metodat dhe teknologjitë e ndryshme të ruajtjes së produkteve bujqësore, mjediset frigoriferike me atmosferë të kontrolluar (AK);
 - Të listojë anomalitë fiziologjike dhe dëmtimet pas vjeljes së produktit;
 - Të shpjegojë rëndësinë e kushteve higjieno-sanitare si faktorë të rëndësishëm për të reduktuar humbjet në sasi e cilësi të produktit bujqësor;
 - Të përshkruajë teknologjitë e pasvjeljes, sipas llojit të produktit bujqësor;
 - Të përshkruajë përdorimin e teknologjive të reja në pas vjelje dhe sfidat e së ardhmes;
 - Të shpjegojë përdorimin e teknologjive të paketimit të produktit bujqësor;
 - Të shpjegojë standardet për transportin e produktit bujqësor sipas llojit;
 - Të listojë llojet e ambalazhit dhe përdorimet e tyre;
 - Të përshkruajë llojet e dhomave frigoriferike, magazinave etj., si dhe pajisjeve të ruajtjes së produktit;
 - Të përshkruajë teknologjitë e seleksionimit dhe vendosjes së produktit për ruajtje;
 - Të listojë llojet e konservantëve dhe përdorimet e tyre;
 - Të krahasojë mënyrat dhe teknikat e manipulimit të produktit për ruajtje dhe trajtim të mëtejshëm;
 - Të përshkruajë rregullat e etiketimit të produktit;

Standardet e cilësisë dhe marketingut të produkteve bujqësore

- Të përshkruajë produktet bujqësore në përputhje me kërkesat e tregut;
- Të konsultojë regjistrin e përditësuar të PMB-ve për garantimin e cilësisë së produkteve;
- Të argumentojë përdorimin e inputeve kimike për garantimin e cilësisë së produktit dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Të interpretojë karencën e produkteve të mbrojtjes së bimëve, të përdorura;
- Të interpretojë afatin e vjeljes (teknike ose biologjike) në varësi të destinacionit tregtar;
- Të shpjegojë rolin e zbatimit të parametrave të transportit për garantimin e cilësisë së produktit;
- Të shpjegojë standardet dhe parametrat e dezinfektimit të magazinave, mjeteve, pajisjeve dhe materialit paketues;
- Të shpjegojë rëndësinë e ambalazhimit dhe materialeve ambalazhuese për garantimin e cilësisë së produktit;
- Të listojë standardet e certifikimit në bujqësi, trupat certifikuese dhe laboratorë të akredituar për analizat e produkteve bujqësore;

- Të shpjegojë standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor në fuqi që lidhet me cilësinë e prodhimeve;
- Të përshkruajë sistemet dhe kriteret e vlerësimit të cilësisë të prodhimeve dhe të fermës;
- Të listojë format e partneritetet për garantimin e cilësisë së kërkuar të produktit;
- Të shpjegojë produktet me origjinë (produktit me tregues gjeografik të mbrojtur).
- Të përshkruajë procedurat për certifikimin e produkteve;
- Të shpjegojë parimet e certifikimit vullnetar (p.sh. produktet me tregues gjeografik të mbrojtur, produktet biologjike etj.);
- Të përshkruajë elementët e kërkuar për gjurmimin në hyrje dhe në dalje të produkteve të ndryshme (identifikimi i operatorëve, produkteve, përpunimeve, etj.);
- Të shpjegojë standartet lidhur me administrimin korrekt të cilësisë gjatë gjithë zinxhirit të shpërndarjes;
- Të përshkruajë parimet ligjore përkatëse dhe rregulloret në fushën e sigurisë dhe higjienës së produkteve ushqimore.

Planifikimi dhe organizimi i punës

- Të përshkruajë strukturat e organizimit të njësisë së prodhimit bujqësor;
- Të shpjegojë llojet e mjeteve të punës, funksionin dhe përdorimin e tyre;
- Të listojë burimet e nevojshme dhe mënyra e planifikimit të tyre për prodhimin e një produkti të caktuar;
- Të shpjegojë mënyrat e menaxhimit të mjeteve, pajisjeve, burimeve njerëzore, dhe financiare të nevojshme për prodhimin e një produkti të caktuar.
- Të përshkruajë mënyrat e sigurimit të mjeteve, pajisjeve, burimeve njerëzore dhe financiare;
- Të përshkruajë mënyrat e organizimit të proceseve të punës dhe monitorimit të saj;
- Të shpjegojë mënyrat e regjistrimit në kohë të të dhënave në librin e fermës;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe format e bashkëpunimit me specialistë dhe aktorë në zinxhirin e vlerës në bujqësi;
- Të argumentojë mënyrat e raportimit dhe formatet përkatëse;
- Të listojë faktorët që ndikojnë në performancën e njësisë;
- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit dhe monitorimit të sistemimit dhe pastrimit të vendit të punës;
- Të shpjegojë qasjet e orientimit drejt tregut; klienti, konkurrentët, organizimi i brendshëm.

Administrim biznesi bujqësor

- Të listojë llojet e dokumentacioneve sipas përdorimit të tyre;
- Të perifrzojë parimet bazë të kodit të punës;
- Të përshkruajë legjislacionin bazë të fushës së bujqësisë lidhur me aktivitetin që kryen;
- Të interpretojë rregulloren e brendshme të njësisë;
- Të shpjegojë format dhe mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
- Të përshkruajë llojet e planeve ditore, javore, mujore dhe vjetore të punës;

- Të përshkruajë mënyrat e përpilimit të një urdhri pune;
- Të përshkruajë mënyra e plotësimit të dokumentacionin teknik përkatës;
- Të përshkruajë legjislacioni tatimor në fushën e bujqësisë;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes paraprake të kërkesës për inpute, materiale dhe kohës së punës;
- Të përshkruajë preventivin e një produkti, elementet përbërës dhe llogaritjet përkatëse;
- Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së një oferte;
- Të shpjegojë elementët dhe mënyrën e llogaritjes së kostos dhe çmimit të një produkti;
- Të analizojë tregun lokal dhe atë për eksport për prodhimet e realizuara;
- Të analizojë nevojat për promovim, teknikat e marketingut tradicional dhe digjital;
- Të dallojë llojet e faturave dhe mënyrën e plotësimit të tyre;
- Të përshkruajë llojet e kontratave, mënyrat e plotësimit dhe zbatimit të tyre;
- Të listojë programe dhe sisteme digjitale për kryerjen e detyrave administrative dhe tregtare dhe rëndësinë e tyre;

Komunikimi në biznes

- Të përshkruajë mënyrat e komunikimit dhe metodat kryesore në fushën e prodhimit bujqësor;
- Të listojë format e pritjes së klientit dhe komunikimi me të;
- Të përshkruajë teknikat e promovimit, reklamimit, këshillimit dhe informimit të klientit;
- Të shpjegojë parimet e punës në grup;
- Të listojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të analizojë parimet bazë të kodit të etikës;
- Të shpjegojë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimi kritik;
- Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunësorëve dhe rolin e i tyre në veprimtarinë profesionale;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimi i TIK⁵ në komunikimin me të tjerët;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimi i terminologjisë profesionale në gjuhë amtare dhe në gjuhë të huaj;
- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.

Siguria në punë

- Të shpjegojë Standardin ndërkombëtar 18001;
- Të shpjegojë Standardet dhe legjislacionin shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
- Të argumentojë domosdoshmërinë e përdorimin të manualeve të mjeteve e pajisjeve të punës;

⁵ Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

- Të shpjegojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës;
- Të listojë llojet e mjeteve të ndihmës së parë dhe përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë procedurat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të interpretojë sinjalistikën në mjedisin e punës;
- Të shpjegojë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
- Të shpjegojë përdorimin e pajisjeve të MZSH⁶;
- Të listojë masat dhe rregulloret përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
- Të shpjegojë masat mbrojtëse gjatë përdorimit të produkteve fitosanitare në bujqësi;
- Të listojë mënyrat e identifikimit të mosfunksionimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e raportimit në kohë për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e sigurimit të ambientit të punës nga dëmtimet;
- Të përshkruajë standardet e përshtatshme për punonjësit me aftësi ndryshe;

Mbrojtja e mjedisit

- Të shpjegojë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të lëndëve dhe energjisë në fermë në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë në fermë;
- Të përshkruajë standardet ekologjike për mbrojtjen dhe sigurimin e cilësisë në mjedisin e fermës;
- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të burimeve tokësore e ujore për zhvillim të qëndrueshëm;
- Të listojë llojet e mbetjeve dhe rrezikun e tyre për ndotjen e mjedisit;
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- Të shpjegojë rregullat e ruajtjes dhe depozitimit të mbetjeve në përputhje me rregulloret e mjedisit;
- Të shpjegojë normat teknike të përdorimit të input-eve në bujqësi sipas kulturave dhe ndikimin e tyre në mjedis;
- Të përshkruajë llojet e ambalazheve të përshtatshme dhe ekologjike që janë miqësor me mjedisin;
- Të shpjegojë proceset e riciklimit të mbetjeve organike dhe rëndësinë e tyre;
- Të përshkruajë Protokollat e duhura në raste pandemie dhe epidemie.

⁶Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi

SHPREHI PROFESIONALE

Bazat e bujqësisë

- Të përcaktojë përshtatshmërinë e kushteve agroklimatike për kulturat bujqësore;
- Të zbatojë kriteret e rajonizimit të kulturave bujqësore;
- Të përzgjedhë bimët bujqësore sipas traditave të kultivimit dhe kërkesave të tregut;
- Të përzgjedhë strukturën varietore të kulturave bujqësore;
- Të interpretojë analizat e tokës për hartimin e skemës së plehërimit;
- Të përcaktojë nevojat për ujë sipas kulturave bujqësore bazuar në evapotranspirimin;
- Të garantojë rritjen dhe zhvillimin optimal të bimëve bujqësore;
- Të zbatojë skemat e qarkullimit bujqësor;

Teknologjitë e prodhimit bujqësor

- Të zbatojë sistemet e ndryshme të prodhimit bujqësor: konvencional, biologjik, të integruar, biodinamik, agropyjor;
- Të përzgjedhë kulturat bujqësore sipas karakteristikave të tokës;
- Të kryejë trajtimet e duhura të tokës para mbjelljes për ruajtjen e cilësisë së prodhimit;
- Të përzgjedhë mënyrat e duhura të punimit të tokës sipas sistemit të kultivimit;
- Të përzgjedhë sistemin e kultivimit dhe proceset përkatëse të punës;
- Të zbatojë skemat e ushqyerjes së bimëve sipas llojit;
- Të menaxhojë sistemin e ujitjes sipas teknologjive të kulturave;
- Të menaxhojë dëmtuesit e zakonshëm dhe ato karantinore të bimëve bujqësore;
- Të zbatojë metodat dhe teknikat e mbrojtjes së bimëve sipas dëmtuesve;
- Të respektojë protokollet e mbrojtjes së bimëve sipas kulturave bujqësore;
- Të përzgjedhë PMB sipas përdorimit;
- Të kryejë shërbimet agroteknike sipas fazave të zhvillimit të bimës;
- Të përcaktojë afatin optimal dhe teknikat e vjeljes së produktit sipas kërkesave të tregut;
- Të përdorë teknologji të reja në prodhimin bujqësor;
- Të përdorë teknologjitë të reja në menaxhimin e fermës .

Teknologjitë e pas vjeljes dhe ruajtjes

- Të matë ndryshimet fizike, kimike dhe fiziologjike të produkteve bujqësore para dhe pas vjeljes;
- Të zbatojë kriteret e përcaktimit të shkallës së pjekjes për vjelje;
- Të analizojë humbjet dhe faktorët ndikues gjatë proceseve në fermë;
- Të zbatojë praktikatat e mira të trajtimeve të produkteve para dhe pas vjeljes;
- Të mbikëqyrë materialet, mjetet dhe teknikat e përdorura gjatë trajtimeve para dhe pas vjeljes;
- Të menaxhojë sistemin e paraftohjes dhe ruajtjes së ftohtë të produkteve;
- Të zbatojë kushtet optimale të ruajtjes për sigurimin e cilësisë;

- Të menaxhojë mjediset frigoriferike me atmosferë të kontrolluar;
- Të parandalojë çrregullimet fiziologjike dhe dëmtimet pas vjeljes së produktit;
- Të respektojë kushtet higjieno-sanitare për të zvogëluar humbjet në sasi e cilësi të produktit bujqësor;
- Të përzgjedhë teknologji të reja të pas-vjeljes sipas produktit bujqësor;
- Të mbikëqyrë zbatimin e standardeve të seleksionimit të produktit sipas llojit dhe parametrave të kërkuara;
- Të mbikëqyrë magazinimin e produktit sipas llojit dhe parametrave të kërkuara;
- Të mbikëqyrë proceset e trajtimeve të produktit për ruajtje dhe trajtim të mëtejshëm sipas llojit të produktit;
- Të mbikëqyrë zbatimin e standardeve të ruajtjes së produkteve, sipas llojit dhe parametrave të kërkuara;
- Të mbikëqyrë zbatimin e standardeve të paketimit dhe etiketimit të produktit, sipas destinacionit;

Standardet e cilësisë dhe marketingut të produkteve bujqësore

- Të përzgjedhë produktet bujqësore në përputhje me kërkesat e tregut;
- Të përzgjedhë PMB në regjistrin e përditësuar për garantimin e cilësisë së produkteve;
- Të mbikëqyrë përdorimin e inputeve kimike për garantimin e cilësisë së produktit dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Të respektojë karencën e produkteve të mbrojtjes së bimëve, të përdorura;
- Të respektojë afatin e vjeljes (teknike ose biologjike), në varësi të destinacionit tregtar;
- Të mbikëqyrë zbatimin e parametrave të transportit për garantimin e cilësisë së produktit;
- Të zbatojë standardet dhe parametrat e dezinfektimit të magazinave, mjeteve, pajisjeve dhe materialit paketues;
- Të zgjedhë paketimin dhe materialin ambalazhues për garantimin e cilësisë së produktit sipas produktit;
- Të përzgjedhë trupat certifikuese dhe laboratorë të akredituar për analizat e produkteve bujqësore;
- Të zbatojë kuadrin ligjor vendas, në fuqi, dhe standardet ndërkombëtare që lidhet me cilësinë e prodhimeve;
- Të zbatojë kriteret e vlerësimit të cilësisë të prodhimeve dhe të fermës;
- Të përdorë format e partneritetet për garantimin e cilësisë së kërkuar të produktit;
- Të zbatojë kriteret për prodhimin e produkteve me origjinë (produktit me tregues gjeografik të mbrojtur).
- Të respektojë procedurat për certifikimin e produkteve;
- Të zbatojë parimet e certifikimit vullnetar (p.sh. produktet me tregues gjeografik të mbrojtur, produktet biologjike etj.);
- Të identifikojë elementët e kërkuar për gjurmimin në hyrje dhe në dalje të produkteve të ndryshme (identifikimi i operatorëve, produkteve, përpunimeve, etj.);
- Të zbatojë standardet lidhur me administrimin korrekt të cilësisë gjatë gjithë zinxhirit të shpërndarjes;

- Të mbikëqyrë zbatimin e parimeve ligjore përkatëse dhe rregulloreve në fushën e sigurisë dhe higjienës së produkteve ushqimore.

Planifikimi dhe organizimi i punës

- Të përcaktojë strukturat e organizimit të njësisë së prodhimit bujqësor;
- Të mbikëqyrë funksionimin dhe përdorimin e mjeteve të punës;
- Të planifikojë burimet e nevojshme për prodhimin e një produkti të caktuar;
- Të sigurojë mjetet, pajisjet, burimet njerëzore dhe financiare;
- Të menaxhojë burimet njerëzore, financiare dhe logjistike të nevojshme për prodhimin e një produkti të caktuar.
- Të mbikëqyrë mënyrat e organizimit të proceseve të punës;
- Të regjistrojë në kohë të dhënat në librin e fermës;
- Të bashkëpunojë me specialistë dhe aktorë në zinxhirin e vlerës në bujqësi;
- Të raportojë sipas mënyrave dhe formateve përkatëse;
- Të mbikëqyrë faktorët ndikues në performancën e njësisë;
- Të mbikëqyrë sistemin dhe pastrimin e vendit të punës;
- Të zbatojë qasjet e orientimit drejt tregut; klienti, konkurrentët, organizimi i brendshëm.

Administrim biznesi bujqësor

- Të përdorë dokumentacionin e duhur në fermë ;
- Të zbatojë parimet bazë të kodit të punës;
- Të zbatojë legjislacionin bazë të fushës së bujqësisë lidhur me aktivitetin që kryen;
- Të zbatojë rregulloren e brendshme të njësisë;
- Të mbikëqyrë format dhe mënyrat e arkivimit të dokumentacionit;
- Të ndjekë planet ditore, javore, mujore dhe vjetore të punës;
- Të përpilojë urdhra pune dhe dokumente teknik të nevojshëm;
- Të zbatojë legjislacionin tatimor në fushën e bujqësisë;
- Të llogaritë kërkesën për inpute, materiale dhe kohën e punës;
- Të përpilojë preventivin e një produkti;
- Të përgatitë oferta sipas produktit dhe kërkesave të tregut;
- Të llogaritë kostot dhe çmimin e një produkti;
- Të mbikëqyrë tregun lokal dhe atë ndërkombëtar për shitjen e prodhimeve të realizuara;
- Të zbatojë teknikat e marketingut tradicional dhe digjital;
- Të plotësojë faturat sipas standardeve të përcaktuara;
- Të zbatojë kontratat me të tretët, sipas rastit;
- Të përdorë programe dhe sisteme dixhitale për kryerjen e detyrave administrative;

Komunikimi në biznes

- Të zbatojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të zbatojë parimet bazë të kodit të etikës;
- Të respektojë rregullat e komunikimit etikë dhe profesional me kolegë, eprorë dhe të

tjerët;

- Të respektojë format e pritjes së klientit dhe komunikimi me të;
- Të zbatojë teknikat e informimit të klientit;
- Të zbatojë parimet e punës në grup;
- Të zbatojë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimi kritik;
- Të respektojë bashkëpunëtorët dhe rolin e tyre në veprimtarinë profesionale;
- Të përdorë TIK në komunikimin me të tjerët;
- Të përdorë terminologjinë profesionale në gjuhë amtare dhe në gjuhë të huaj;
- Të respektojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.
- Të menaxhojë stresin;

Siguria në punë

- Të respektojë Standardin ndërkombëtar 18001;
- Të respektojë Standardet dhe legjislacionin shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
- Të përdorë manualët e mjeteve e pajisjeve të punës;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës;
- Të përdorë mjetet e ndihmës së parë sipas nevojës;
- Të zbatojë rregullat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të respektojë sinjalistikën në mjedisin e punës;
- Të respektojë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e MZSH;
- Të zbatojë masat dhe rregulloret përkatëse gjatë përdorimit të lëndëve me përmbajtje kimike;
- Të zbatojë masat mbrojtëse gjatë përdorimit të produkteve fitosanitare në bujqësi;
- Të identifikojë mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të raportojë në kohë për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të zbatojë mënyrat e sigurimit të ambientit të punës nga dëmtimet;
- Të krijojë kushte të përshtatshme pune për punonjësit me aftësi ndryshe;

Mbrojtja e mjedisit

- Të sigurojë një mjedis të qëndrueshëm në fermë;
- Të përdorë lëndë dhe energjinë në fermë në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Të respektojë standardet ekologjike për mbrojtjen dhe sigurimin e cilësisë në mjedisin e fermës;
- Të përdorë me efikasitet burimet tokësore e ujore për zhvillim të qëndrueshëm;
- Të identifikojë llojet e mbetjeve dhe rrezikun e tyre për ndotjen e mjedisit;

- Të respektojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- Të respektojë rregullat e ruajtjes dhe depozitimit të mbetjeve në përputhje me rregulloret e mjedisit;
- Të zbatojë normat teknike të përdorimit të input-eve në bujqësi sipas kulturave dhe ndikimin e tyre në mjedis;
- Të përdorë llojet e ambalazheve të përshtatshme dhe ekologjike, miqësor me mjedisin;
- Të zbatojë proceset e riciklimit të mbetjeve organike;
- Të respektojë Protokollet e duhura në raste pandemie dhe epidemie.

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.